



**SULMET NDAJ GAZETARËVE DHE
PUNONJËSVE MEDIATIK
MË 27 PRILL TË VITIT 2017**

3FM

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

SULMET NDAJ GAZETARËVE DHE PUNONJËSVE MEDIATIK MË 27 PRILL TË VITIT 2017

Autorët:

Dushica Mrgja, gazetare
Enis Murtezi, gazetar
Hristina Bellovska, gazetare

Redaktuar nga:

Dragan Sekullovski dhe Deniz Sulejman

Përkthim në gjuhën shqipe:

Kristina Naceva

Foto:

Agjencia shtetërore e lajmeve (MIA)

Dhjetor 2019, Shkup

Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit "Gazetarë të sigurt për informacione kredibile në Maqedoninë e Veriut" i mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shkup. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësia e vetme e SHGM-së dhe autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pozicionin e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Shkup.

Botuesi: Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM)

Adresa: Gradski zid blloku 13 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
Drejtor i projektit, Dragan Sekullovski
Tel: 00389 (02) 3298-139 email: contact@znm.org.mk

1.	Dhjetor 2019, dy vjet e tetë muaj pas "Të enjtes së përgjakshme" të 27 Prillit 2017	3
2.	Sulmi ndaj gazetarëve në Kuvend nga perspektiva e faktorëve politikë	11
	2.1. "E ndamë të njëjtin fat"	12
	2.2. "Atë ditë askush nuk ishte i sigurt"	14
	2.3. Partitë për të "Enjten e përgjakshme" dhe sulmi ndaj gazetarëve	15
	2.4. Gazetarët sakrifikuan jetën e tyre për t'i transmetuar skenat e përgjakshme	17
3.	Rezoluta e gjykatës për gazetarët e sulmuar më 27 prill	18
	3.1. Përgjegjësia penale	18
	3.2. Parahetimi kryesor për mbrojtjen penale të gazetarëve dy vite e gjysmë „në ler“	20
	3.3. Rasti me kameramanin e sulmuar qëndron në vend nëpër labirintet e gjykatës për dy vjet	22
	3.4. Rruga për drejtësi është më e shkurtër në procedurat civile	24
	3.5. Legjislacioni i sigurisë së gazetarëve	24

DHJETOR 2019, DY VJET E TETË MUAJ PAS “TË ENJTES SË PËRGJAKSHME” TË 27 PRILLIT 2017

Pres-qendra në Kuvend, salla ku u zhvillua një dramë e vërtetë e përgjakshme ende është në funksion. Nga atje deputetët mbajnë konferenca për shtyp çdo ditë, bëjnë deklaratata, gazetarët paraqiten në lajme... Përveç vrimave të plumbave në tavan, nuk ka asgjë për të dëshmuar se një dramë e tillë është luajtur këtu jo shumë kohë më parë.

Shpesh në këtë sallë janë deputetë që atë natë u bllokuan dhe u mbyllën në qoshet e kësaj hapësire, pjesë e kolegëve të tyre që i mbronin ata, si dhe ata deputetë që lejuan që sulmuesit të hynin brenda dhe t'i rrihnin. Vështirë se ndonjë prej tyre e përmend këtë ngjarje. Secili për arsyet e veta.

Në Qendrën e shtypit shpeshherë janë edhe gazetarët. Sidoqoftë, shumë pak nga ata që kaluan 27 prillin atje kujtohen që ata kishin mbijetuar ditën dhe natën më traumatike të jetës së tyre. Entuziazmi se 27 prilli nuk do të mbetet një histori e papërfunduar pothuajse është zhdukur. Një amnisti për disa nga ata që janë drejtpërdrejtë përgjegjës, të cilët ende po ecin nëpër korridoret e parlamentit kanë vlarë shpresën e drejtësisë. Ka pasur dënime për dhunuesit dhe disa prej atyre që janë përgjegjës, por askush nuk është dënuar me burg për dhunimin e një gazetari, kameramani ose fotoreporterit. Mbeten shumë dilema dhe pyetje pa përgjigje.

Rreth orës 13.30, deputeti dhe kryetari i LSDM-së, Zoran Zaev, paraqitet në foltore. Nga foltorja e Kuvendit thotë se durimi i shumicës që ai drejton është drejt fundit. "Për të zgjedhur kryetarin e Kuvendit duhen 61 vota, pavarësisht se ku do të mbahet seanca, tek shkallët e restorantit apo në disa nga sallat e kuvendit, u thotë Zaev kolegëve të tij nga VMRO-DPMNE-ja.

Nervozizmi sa vjen e bëhet gjithnjë e më i dukshëm, tensioni rritet, deputetët po lëvizin, veçanërisht ata të VMRO-DPMNE-së, hyjnë dhe dalin nga salla.

Rreth orës 14, Trajko Veljanoski, kryesuesi i seancës jep sinjal për pauzë. Zaevi paralajmëron konferencë shtypi në pres-qendrën. Ai rithekson që së shpejti mazhoranca e re është e gatshme të zgjedhë Talat Xhaferin si Kryetar. Nuk tregon saktësisht se kur. Më vonë, Antonio Milloshoski në një konferencë për shtyp pohoi se njoftimi i Zoran Zaevit do të thotë një sulm për demokracinë dhe punën e Kuvendit, por gjithashtu "duke zhytur shtetin në një krizë dhe tension edhe më të madh".

Rreth orës 17:50 replikat dhe kundër replikat mes deputetëve të VMRO-DPMNE-së ende vazhdojnë. Deputeti i LSDM-së, Oliver Spasovski, nga foltorja e Kuvendit kërkon të kalohet në pikën tjetër – votim për Kryetarin e Kuvendit. Veljanoski nuk e lejon këtë, me arsyetimin se ka ende që paraqiten në foltore. Deputeti nga VMRO-DPMNE Krsto Mukoski paraqitet në foltore, fillon të këndojë himnin e Maqedonisë dhe të gjithë deputetët ngrihen.

Më pas vazhdon me këngën "Kemi një emër", kurse deputetët e VMRO-DPMNE-së brohorasin "zgjedhje, zgjedhje!". Deputeti i partisë Besa, Zeqirija Ibrahim, edhe pse nuk u paraqit, merr fjalën për ndërhyrje procedurale dhe fillon të këndojë himnin e Shqipërisë. Deputetët ulen, ndërsa mikrofonin i mbetet i ndezur.

Në ora 18:00 Trajko Veljanoski e mbyll seancën dhe largohet. Shumica e deputetëve mbeten në sallë. Ka deputetë nga LSDM-ja, VMRO-DPMNE-ja, Aleanca për Shqiptarët dhe BDI-ja, edhe pse Ali Ahmeti nuk ishte i pranishëm. Këtu janë edhe gazetarët. Ka tendosje dhe tension. Deputetët e VMRO-DPMNE-së e okupojnë foltoren. Deputetët e LSDM vendosin të kalojnë në pikën tjetër - zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit. Deputeti më i vjetër Branko Manojlovski nuk është në sallë për momentin. I dyti në moshë është Ferid Muhiç, i cili e dorëzoi udhëheqësin tek deputeti Goran Misovski si zëvendës. Nga radhët e Kuvendit Goran Misovski u bën thirrje të votojnë Talat Xhaferin për Kryetar të Kuvendit. Deputetët e VMRO-DPMNE-së brohorasin "Ky është një grusht shtet, grusht shtet!". Shumica votoi - Misovski konstatoi 61 vota "PRO" dhe ia urojnë Talat Xhaferit fitoren. Xhaferi njofton një konferencë për shtyp, kurse në pres-qendrën janë të pranishëm deputetët e mazhorancës.

Në ora 19:00 nga Kuvendi flet kryetari i sapo zgjedhur Xhaferi, dhe në të njëjtën kohë ka një transmetim të drejtpërdrejtë në TV NOVA, televizion që më nuk ekziston. Turma e njerëzve që kishin protestuar për ditë të tëra, në ora 18 u hodhën mbi gardh dhe u mblodhën jashtë portës kryesore të Kuvendit. Në momentin tjetër u hap dera dhe hynë protestuesit. Filluan të dëgjoheshin

britma, zhurma dhe sharje. Kryetari i ri i Kuvendit merr një sinjal nga partia e tij për të përfunduar fjalimin e tij. Me qëllim që ta parandalojnë turmën të hyjë brenda, e mbyllin derën dhe heqin bravën. Xhaferi, Zaev, Spasovski, Mançevski, Sela dhe Dimitrievski i heqin kravatat. Deputetet zbresin poshtë galerisë në fund të pres-qendrës, me çka lëshuan një shkallë të improvizuar nga tavolina e punës. Protestuesit tashmë janë tek dera. Dëgjohet zhurma e goditjes së derës dhe britma. Dera hapet dhe në pres-qendrën e shtypit hynë një turmë e zemëruar. Disa prej tyre mbajnë maska të zeza dhe bluza të zeza dhe duken sikur koordinojnë tryezën.

Një nga gazetarët që atë ditë raportnin nga Kuvendi ishte **Goran Tërpenoski**, i cili gjatë ndërhyrjes ishte në pres-qendrën.

“

“Rrëmbyesit filluan të godisnin me gjithçka që gjetën në sallë, duke bërë titur uraaaa... Zaev dhe deputet të tjerë u sulmuan dhe u lënduan, pothuajse të gjithë ishin me koka të gjakosura dhe hundë të thyera. Deputeti Ziadin Sela u rrah gati për vdekje. Disa nga gazetarët ikën, por unë qëndrova me kolegët tjerë. Si gazetar, ishte detyra ime të shikoja se çfarë po ndodhte për të paralajmëruar publikun për një sulm të organizuar në Kuvend dhe me këtë të bëj thirrje deri te autoritet të reagojnë. Madje një herë nuk kishte mjaft njerëz që qëndronin në murin e gjallë që e mbronin Zaevin, Xhaferin dhe deputetët tjerë. Sikur të mos vinte deputeti Vllatko Gjoçev, për të mbrojtur Zaevin dhe të tjerët, historia maqedonase sot do të ishte ndryshe. I tmerruar më kërkoi të qëndroja tek muri i gjallë për të ndihmuar, sepse nuk kishte njerëz të mjaftueshëm. Kur fotografitë dhe raportet e mjaftueshme ishin dërguar tashmë në publik, a bateritë e telefonave pëlcisnin, nga koha kur policia ndërhyri unë isha në një mur të gjallë duke mbrojtur deputetët nga banditë e mbetur në sallën e shtypit. Kaos. Sigurim dhe polic nuk kishte. Pothuajse dy orë mbetëm në mëshirën e sulmuesve, policia erdhi dy orë më vonë për të na larguar. Faqe të tëra mund të shkruaj për 27 Prillin - këtë ditë që dua ta harroj. Të nesërmen erdha në Kuvend në vendin e sulmit. Mbetjet po pastroheshin dhe ne po prisnim që Ministria e Punëve të Brendshme të hapte Sallën e shtypit në Kuvend. I komentua ngjarjet, por kjo është jeta dhe profesioni i gazetarisë që dua. Vazhdova të punoja sikur asgjë të mos kishte ndodhur. Por, për tërë situatën se sa ishte e rrezikshme për jetën i vetëdijshëm isha vetëm pas disa ditëve, kur kaloi adrenalina dhe kur i shikoja videot dhe fotografitë dhe kur i shikoja lajmet. Të mos përsëritet!”

”

Pjesëmarrësit në turmën në pres-qendrën goditnin me gjithçka që u vinte në dorë. Papritur u dëgjua një krisëmë me armë zjarri që tërhoqi të gjithë vëmendjen në pres-qendrën. Turma për një moment ndaloi, për të vazhduar edhe më të zemëruar. Lideri i Aleancës për Shqiptarët tashmë është në dysheme, fytyra e tij ishte e mbuluar me gjak. Në mënyrë gjakësore e godisnin në kokën e tij. Disa e kapën për krahu dhe filluan ta tërheqin.

Dimitar Tanurov është gazetar që atëherë raportonte për Agjencinë e Lajmeve Meta. Ai është një nga gazetarët më të goditur në dhunën e së enjtes të përgjakshme. Pothuajse tre vjet pas 27 prillit, Tanurov thotë se pasojat e anarkisë që varrosi demokracinë atë ditë do të jenë të përjetshme.



“Ku njeriu vdes të afërmit e tij mbesin për t’u përballur me humbjen, të pikëlluar. Sipas krishterimit, i ndjeri nderohet deri në vitin e tretë të vdekjes së tij, dhe gjatë asaj kohe të afërmit e tij kalojnë nëpër pesë faza: mohim, zemërim, “pazarllëk”, depresion dhe pranim që jeta vazhdon pa të ndjerin. Së shpejti përfundojnë tre vite nga 27 prilli e njohur si “E enjtja e përgjakshme” - dita që anarkia shkatërroi demokracinë, kurse liria e informacionit ishte në likuidim. Atë ditë askush nuk mund ta besonte atë që po ndodhte, as ata të tronditur që shikonin ngjarjet në ekranet televizive apo rrjetet sociale, madje as gazetarët deri sa raportonin për kaosin u bënë një objektiv lëvizës. Unë u sulmova dhe u përgjaka sepse po xhiroja.

Ne qafë mbaja një kartë-shtypi, por kjo i zemëroi ata edhe më shumë, veçanërisht kur ata panë se për cilin medium po punoja. Pas goditjes së parë rashë në tokë, pastaj 5-6 persona me grushte dhe shkelma më goditën në zonën e kokës dhe stomakut, duke u munduar të ma marrin telefonin në të cilin kisha xhirime. Në një moment ata arritën të më vidhnin, por ata nuk pushuan duke më goditur. Ndihesha sikur do të zgjaste përgjithmonë, se ata kurrë nuk do të ndaleshin dhe se çdo frymë, mund të jetë e fundit. Në një moment dëgjova një zë që thoshte: “Lëre, kolegu im është ... OK njeri dhe gazetar!” Dhe i njëjti person, fytyrën e të cilit fatkeqësisht nuk arrita ta kujtoja, filloi të më tërhiqte dhe arriti të më nxjerrë nga salla... Diku më vonë, disi i hutuar, me fytyrë të përgjakur rija para derës së sallës mu afrua një djalë, i cili më ftoi të shkoja me të për të më nxjerrë jashtë. E vështrova me mosbesim dhe hezitua ta ndiqja, sepse nuk dija nëse qëllimet e tij ishin të sinqerta ose mund të bija në një pritë të re. Sidoqoftë, vendosa ta dëgjoja. Duke vendosur një peshqiri në fytyrën time më nxori nga Kuvendi dhe rrugës për në turmë po thoshte “është i joni, pa dashje e lënduan”. Unë jam jashtëzakonisht mirënjohës për këta dy, identitetin e të cilëve nuk

e njoh. Nëse nuk do të ishin ata, me siguri nuk do të përfundoja vetëm me një tronditje në kokë. Unë e raportova sulmin në polici dhe identifikova një nga sulmuesit, por rasti u regjistrua si grabitje. Për gati 10 ditë nuk mund të merrja konfirmim se kisha raportuar rastin, dhe prokuroria më thirri të dëshmoja gati gjashtë muaj më vonë. Ndoshta krahasimi i kësaj ngjarje të tmerrshme me qëllim vdekjen duket i ekzagjeruar, por duke pasur parasysh atë që mbijetuam dhe në çfarë faza kemi kaluar pas ngjarjes, gjithnjë e më shumë duket si kjo. Kjo pikë e zezë në historinë e shtetit duhet të jetë një pikë kthese për rilindjen e demokracisë, lirinë e informacionit, sundimin e ligjit, një fund për mosndëshkimin dhe kthimin e besimit tek institucionet e sistemit. Zhvillimet e fundit në vend gjithnjë e më shumë po tregojnë se ne jemi tani në fazën e parafundit të pikëllimit - depresionit, pas së cilës do të duhet të pajtohemi dhe të ecim më tej me jetën. Nuk jam i lumtur të flas për “Të enjten e përgjakshme”, sepse atë e pashë me sytë e mi, e ndjeva atë në lëkurën time, si dhe për ngjarjet që pasuan. Atë askush nuk e meriton ta përjetojë”.



Zimer Jashari, gazetar në TV 21, tërë ditën e kalon në Kuvend. Ndërsa turma tërbohohet në pres-qendrën, ofendimet janë në bazë nacionale, me një retorikë nacionaliste, shoviniste dhe fyese ndaj shqiptarëve. Jashari u bë shënjestër e dhunuesve.



“E gjithë situata eskalonte për shkurt kohë, dhe ne filluam të ikim korridoreve, duke u fshehur dhe duke kërkuar një rrugëdalje nga shtëpia ligjvënëse. Tre persona më detyruan të futem në bufe, duke më akuzuar se isha shqiptar dhe duke më thënë se “motrat dhe gratë tona janë të bukura” dhe më kërkuan që t’u shpjegoja atyre se çfarë kam raportuar për ngjarjen. Më fyen me fjalë poshtëruese. Ajo që më mahniti më shumë është se përveç dhunës fizike që kam përjetuar, dhe që akoma sot e asaj dite kam pasoja dhe lëndime në gju dhe këmbë, lëndime që pësova nëpër ulëset gjatë përpjekjes për të ikur, unë e padita edhe shtetin, por deri sot nuk kam asnjë reagim për raportin tim. Gazetarët, kameramanët dhe të gjithë përfaqësuesit e mediave në terren janë ata që japin më shumë, janë më pak të paguar dhe janë mbrojtësit më të mirë të profesionit më të mirë në botë - gazetarisë. Jo vetëm që ata duhet të mbrohen dhe mbështeten, por ata gjithashtu kanë nevojë për ndihmë, pasi ata shpesh ndodhen midis tre zjarreve: protestuesit, policisë dhe politikës redaktuese. Ata janë njerëz që nuk kanë orar të caktuar, punojnë ditë e natë, në shi dhe diell, ndonjëherë ngulfaten nga gazet lotsjellëse.”



Edhe **Iskra Opetqeska** në të „Enjten e përgjakshme" nga Kuvendi raportonte për TV 21. Atë ditë edhe ajo ishte lënduar. Tre vjet më vonë, dëshmoi se ata që mbijetuan në 27 Prill në Kuvend, në të ardhmen, duhet ta festojnë atë datë si ditëlindjen e dytë.

“As pas tre viteve, as pas njëzet vitet e ardhshme , nga koka nuk do të më del gjaku që pashë atë ditë në sytë e atyre që u sulmuan në Kuvend. Ende rrëqethem nga mendimi kur i gjithë tërbimi mbi gjithçka, atë natë u derdh mbi këdo që u gjet para syve të sulmuesve. Ende kërkoj sqarim se çfarë ndodhi atë ditë. Dita që supozohej të ishte një festë e demokracisë u shndërrua në një ditë me gjaku, dita e paqartësisë, ditë me aromë baruti dhe kjo ditë para se gjithash duhet të jetë ditëlindja e dytë e të gjithë neve që punuam atë natë në Kuvend. Tre vjet më vonë, edhe njëzet e më shumë vite nuk do të zhduket ndjenja ime e pikëllimit, trishtimit, zemërimit, pafuqisë. Në ato momente, unë kuptova forcën e brendshme që as nuk mund ta dija se kisha, gjë që më ndihmoi të ruaj arsyeshmërinë, qetësinë dhe racionalitetin. Jam krenare për angazhimin tim profesional atë ditë, por edhe e lumtur që nuk kishte njerëz që humbën jetën.”

Gabriela Dimkoviç Mishevaska më 27 prill në Kuvend gjithashtu ka raportuar për portalin A1on dhe agjencinë "Makfax". Ajo është gjendur në shtëpinë ligjvënëse deri në momentin e evakuimit të deputetëve, gazetarëve dhe shërbyesve të Kuvendit. Ka raportuar për dhunën në pres-qendrën, në sallën e Kuvendit, por edhe në hollin e Kuvendit. Ajo dëshmon se traumat, stresi, si dhe përgjakjet "fleshbek" e përcjellin edhe pas 27 prillit. Thotë se më e tmerrshme nga të gjitha është se drejtësia për gazetarët edhe pas tre vitesh më vonë nuk erdhi.

“27 prilli i vitit 2017 ishte dhe do të mbetet dita më e gjatë e jetës time. Ajo ditë tensionuese në Kuvend e cila kulminoi me dhunë brutale dhe skena të përgjakshme nuk është lehtë të harrohet. Ajo ditë më ndryshoi si person por edhe si gazetar. Mund të them që jam pjekur, por nuk iu kam mbijetuar traumave që i sollti. Asgjë nuk mund të më befasojë më pas kësaj ngjarje. Gjatë kohë pas 27 Prillit, kisha netë pa gjumë, ëndrra të çuditshme që më zgjonin në mes të natës. Në atë periudhë, për mua ishte e rëndësishme të ruaja

mendjen dhe shëndetin tim, pasi menjëherë pas ngjarjeve mbeta shtatzënë dhe patjetër më duhej të kujdesesha për jetën tjetër që po zhvillohej brenda meje. Edhe përkundër kësaj, mua më duhej të jepja deklarata në Prokurori në cilësinë e dëshmitares pra për t'i kujtuar dhe t'i përjetoj për së dyti herë traumat. Këto janë momente të cilat nuk harrohen. Epilogu i gjithë situatës nuk më lumturon aspak në raport me ata që duhej të ishin ndëshkuar. Një grup që ishte pjesë e organizatës është dënuar, por drejtësia nuk është përmbushur plotësisht. Nuk e di se di do të jetë epilogu i procedurës për dëmshpërblim që kemi parashtruar së bashku me kolegun tim kameraman i cili pësoi tronditje në tru, por e di që nuk dua të fali. Kjo ngjarje nuk meriton mëshirë, por përgjegjësi dhe jo drejtësi selektive sa për të na i fërkuar sytë. Avokati i cili udhëheq procedurën tonë na porositi që të mos presim shumë kur bëhet fjalë për dëmshpërblim nga shteti. Pse askush nuk mori parasysh të mbrojë gazetarët dhe kameramanët të cilët mund të ishin shënjestër e turmës? Unë nuk harroj, nuk fal, kërkoj përgjigje dhe do të vazhdoj të kërkoj derisa të zbardhet e gjithë e vërteta.”

Branko Gjogovski në atë kohë ishte ndihmës redaktor në *Dnevnik*. Gjendej në Kuvend si gazetar. Së bashku me Goran Tërpenovskin e pranuan thirrjen e Vllatko Gjorçevit dhe qëndruan në mburojën e gjallë midis deputetëve dhe sulmuesve. Sot, gati tre vjet më vonë, dyshohet se dikush ka vendosur që sulmi mos të zbatohet deri në fund. Sipas dëshmisë së tij, madje edhe policia disi ishte si bashkëpunuese në sulm.

„Aksioni policor dukej si thjesht sikur të dukej një veprim i vërtet policor për të nxjerrë deputetët. Policia në atë kohë nuk kishte shtypje nga protestuesit dhe gjithçka përfundoi praktikisht. Kryesisht për shkak se ata që qëndronin në radhën e fundit nuk zgjodhën të sulmonin, por thjesht të japin deklarata të revoltuara. Nëse do të kishte pasur një skenar për të futur gjendje lufte, ajo do të anulohet para ndërhyrjes. Ishte e qartë për mua gjatë atyre orëve derisa ngjarja po zgjaste dhe isha i sigurt se do të mbaronte. Për këtë arsye, unë nuk i konsideroj të dënuarit e 27 Prillit si terroristë dhe që kanë kryer një krim të terrorizmit që duhet të ndëshkohen shumë ashpër”.

Dushica Mërgja është një raportuese parlamentare e cila për më shumë se 15 vite raporton çdo ditë nga Kuvendi. Thotë se nga "aeroplani" vërehej se ajo ditë do të ishte më ndryshe, sepse tërë ditën është ndjerë nervoz dhe tension. Dushica ishte në pres-qendrën e shtypit kur turma sulmoi. Ajo së pari vuri re sulmuesit e maskuar dhe përshtypja ishte se ata e dinin saktësisht se ku po shkonin dhe kë po kërkonin. Ajo raportoi me telefon në programin e inkuadruar drejtpërdrejtë. Ajo pësoi disa goditje në kokë dhe një dëmtim të shpatullës.

“Adrenalina më goditi menjëherë. Po kërkoja ndonjë mënyrë për të kontaktuar me TV 24 për t’i njoftuar ato se çfarë po ndodhte. Ndërsa çmenduria përparonte, ashtu rritej edhe frika. Nuk kisha përgjegjësi vetëm për vetën time, por mendoja edhe për ekipin tim të TV 24. E dija që isha më e zëshme dhe më e detajuar në eter, ashtu mundësitë për të mbijetuar janë të mëdha për të gjithë.

Për atë që protestuesit dhe sulmuesit me njohin nga ekrani për mua ishte një hendikep shtesë. Tradhtare, lavire, shërbëtore e Zaevit, një “kurvë” shqiptare ishin vetëm disa nga fyerjet që më “qerasën”. Më goditën në mur, mora një goditje të fortë në krah që sot e asaj dite kam dhimbje tek shpatulla. Mora një goditje edhe në fytyrë. Kur kërkoja ndihmë nga një anëtar i sigurimit të parlamentit për Natasha Stojanovskën, të cilën e kishin mbyllur me një dhomë me pesë protestues, mora përgjigjen “Unë nuk mund të bëj asgjë”.

Gjaku në fytyrën e Ziadin Selës më përndoqi me netë të tëra. Para se të shpërthejnë bombat me tym në qendrën e shtypit, në një video postim në Facebook shihej se jam unë e rrethuar dhe si po përpiqesha me të gjithë forcën të shtytja një nga protestuesit, duke i bërtitur se nuk mund të merrja frymë. Para se të vinin specialistët për të na nxjerrë jashtë, unë me të vërtetë ngulfatesha. Atëherë mendova –mbaroi, nuk do të dalë e gjallë prej këtu. Tre vjet më vonë gjallërisht e kujtoj çdo detal të asaj të enjte të përgjakshme.

Mesazhi im është që nëse nuk ka drejtësi për atë gjak, shteti nuk do të ketë kurrë paqe. Kurse drejtësia selektive, e shpërblyer e zgjeruar nga amnistia selektive nuk është drejtësi. Unë nuk harroj dhe nuk fal, sepse atë natë shteti ishte në gjunjë, kurse të gjithë ne të linçuar.”

Në ora 22 00 jashtë ishte errësirë. Tymi nga bombat e tymit po përhapej në të gjithë Kuvendin. Dëgjoheshin britma dhe thyerje qelqi. Gazetarët janë duke pritur për evakuimin e tyre. Ata dëshmojnë se pasi policia hyri u shfaq një

qetësi. Qendra e evakuimit ishte zyra e Vllatko Gjorcevit. Kishte deputetë dhe gazetarë atje, disa me kokë të përgjakura, hundë të thyer dhe disa me rroba të grisura, ishin Zoran Zaev dhe Talat Xhaferi. Për një orë u bë një kordon për evakuim. Disa nga gazetarët u larguan nga lokacioni pa e pritur policinë, mbi rrezikun e tyre.

Përmbyllje: "Nuk ka drejtësi, nuk ka paqe" - në një kohë brohorisin të ashtuquajturit revolucionarë laramanë . Tre vjet nga "E enjtja e përgjakshme", kurse gazetarët, kameramanët, fotografët që atë natë e humbën shpresën se do të largohen nga Kuvendi të gjallë janë të njëzëshëm- drejtësia i kaloi ata .

2.

SULMI NDAJ GAZETARËVE NË KUVEND NGA PERSPEKTIVA E FAKTORËVE POLITIKË

Në "Të enjten e përgjakshme" - 27 Prill 2017, nga turma të cilët me dhunë u futën në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë nuk u kursyen nga as gazetarët, kameramanët dhe fotografët. Edhe ata ishin shënjestra e dhunës që la një shenjë të zezë për demokracinë në Maqedoni. Pas incidentit të përgjakshëm, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë më 08 maj 2017 u bëri thirrje gazetarëve që të padisin autorët për dëmin e shkaktuar, ndërsa atyre u siguruan ndihmë juridike falas.



Nga SHGM-ja do të sigurohet ndihmë juridike për të gjithë gazetarët që janë sulmuar fizikisht ose të ekspozuar ndaj presioneve dhe kërcënimeve të ndryshme gjatë kryerjes së detyrave të tyre profesionale ose pajisjet e të cilëve janë dëmtuar. SHGM dëshiron të inkurajojë të gjithë gazetarët të ngrenë zërin e tyre kundër sulmeve dhe presioneve të cilave u janë ekspozuar kohëve të fundit dhe të dërgojnë një mesazh për publikun dhe institucionet se ata nuk do të heshtin më mbi dhunën që i janë ekspozuar.



Nga gazetarët gjithashtu është ngritur padi për shtetin për përcaktimin dhe kompensimin e dëmeve të shkaktuara. Në këtë iniciativë janë bashkangjitur mbi 15 gazetarë dhe punonjës të mediave.

Në ditën kur u shpall kjo iniciativë, më 28 dhjetor 2018, një nga organizatorët, gazetari Goran Trpenovski, tha që gazetarët me raportimin e tyre kontribuuan që incidenti të përfundonte pa pasoja të rënda. *"Raportimi ynë kontribuoi që mos të ketë pasoja, vrasje. Prania jonë kontribuoi që gjithë kjo të përfundojë siç ka përfunduar"*, tha Tërpenovski.¹

2.1. "E ndamë të njëjtin fat"

Pas zgjedhjes së Talat Xhaferit si kryetar të ri, me 27 prill të vitit 2017 ndodhi një kaos në Kuvendin e Maqedonisë. Takim i tij i parë zyrtar pas zgjedhjes e bëri me Zëvendës Sekretarin për SHBA-në për Evropën dhe Euroazinë, Hojt Brajan Li. Pas takimit, ai tha se shpresonte se situata do të kthehej në gjendje normale, kurse deputetët e lënduar së shpejti të kthehen në shtëpitë dhe punët e tyre.²

Talat Xhaferi për këtë hulumtim deklaroi se 27 Prilli i vitit 2017 nuk duhej t'i kishte ndodhur në asnjë mënyrë Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sipas tij, gazetarët, kameramanët dhe fotoreporterët që u sulmuan atë ditë, ndanë të njëjtin fat si të gjithë të tjerët që në atë moment ishin në Kuvend.

“

"Fatkeqësisht, fati i gazetarëve u nda me fatin e deputetëve dhe të gjithë të tjerëve që ishin në Kuvend. Pra, ky ishte një fat i pandashëm, nuk mund të ndahej fati i deputetëve, të administratës apo gazetarëve. Por, si tërësi ishte diçka që nuk duhej të kishte ndodhur kurrë. Në këtë kontekst u gjenden edhe gazetarë, të cilët munden dhe nuk munden të identifikoheshin, dhe në atë turmë, ata e ndanë fatin me të gjithë ne që ishim në atë situatë", tha Xhaferi.

”

¹ Publikuar në Makfax: <https://makfax.com.mk/makedonija/makedonija/новинарите-бараат-правда-за-27-април-ке/>

² Publikuar në mkdnews: <https://mkd-news.com/dhaferi-se-nadevam-deka-situatsijata-ke-se-vrati-vo-normala-video/>

Kreu i Kuvendit konstatoi se ka pasur shkelje në aspektin e sigurisë që çoi deri në sulmin e 27 prillit 2017. Sipas tij, ata kanë ndërmarrë disa iniciativa për ta përmirësuar atë pjesë, dhe për të gjithë që punojnë në Kuvend, përfshirë edhe gazetarët, që të mos e përsërisin më kurrë "Të enjten e përgjakshme".

“

“Ne tashmë kemi iniciuar një procedurë për të reformuar sistemin e funksionimit të Kuvendit dhe pavarësinë e tij me tre pika kryesore për funksionim, njëra prej të cilave është pavarësia e sigurisë së brendshme e cila duhet të jetë në kompetencë të plotë hierarkike të Kuvendit, në mënyrë që të parandalohen ndikimet e jashtme në veprim, vendimmarrjen dhe zbatimin e asaj që është një aspekt i detyrueshëm i funksionit që ka siguria e brendshme”, tha Xhaferi.

”

Talat Xhaferi u bën thirrje gazetarëve, kameramanëve, dhe gjithë atyre që në njëfarë mënyre pësuan dëme më 27 Prill të kërkojnë dëmshpërblim.

“

“Kushdo që preket nga një akt që rrjedh nga një veprim që nuk lejohet nga institucioni, duhet të deklarohet për kërkesat për dëmshpërblim. Ndoshka kjo është pika fillestare, që çdokush, në mënyrë individuale, përfshirë edhe mediat, nëse jo edhe vetë shtëpitë e mediave që i kanë akredituar gazetarët për të kërkuar dëmshpërblim. E drejta e gazetarëve dhe e mediave rrjedh nga të gjitha ligjet, të cilat rrethojnë tërë procesin që udhëhiqet para organeve kompetente”, deklaroi Xhaferi.

”

2.2. "Atë ditë askush nuk ishte i sigurt"

Mes të lënduarve të së Enjtes së përgjakshme në Kuvend kishte edhe pjesëtarë të policisë. Ata sulmuan fizikisht dhe kërcënuan gazetarët.³ Pasi mori detyrën, ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, tha që dikush me sa duket kishte shpërdoruar detyrën e tij për të sulmuar deputetët dhe gazetarët. Nga puna ishin suspenduar 23 policë, ndërsa u ngritën më shumë se 40 procedura disiplinore.⁴

Sipas ministrit të Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, në atë ditë, 27 Prill 2017, askush nuk ishte i sigurt.

“Duke u mbështetur edhe në përvojën time - askush në atë ditë nuk ishte i sigurt në ndërtesën e Kuvendit, as ne si deputetë e as gazetarët që ishim në detyrë zyrtare. Në fakt, tashmë ekzistojnë aktgjykime të vlefshme gjyqësore, prova, dëshmi, kështu që nga ky këndvështrim mund të përmbylli vetëm se një gjë e tillë nuk mund të lejohet më kurrë”, tha Ministri Spasovski.

Ai shton se 27 prilli nuk mund të përsëritet kurrë në Maqedoni. Spasovski thotë se pas fillimit të mandatit të tyre dha sqarime të qarta se të gjitha sulmet ndaj gazetarëve do të zbardhen.

“Nga qershori i vitit 2017 e këndeje nuk ka asnjë sulm të vetëm fizik të pa zbardhur ndaj një gazetari, edhe ju jeni dëshmitarë se thjesht një zbardhje e tillë e shpejtë ka kontribuar në uljen e sulmeve ndaj gazetarëve në një nivel minimal”, tha Spasovski.

Spasovski, në lidhje me dëmshpërblimet ndaj gazetarëve për dëmet e shkaktuara thotë se nuk do të ketë dilema se ajo do të ndodhë.

³ Kumtesë e SHGM: <https://znm.org.mk/зnm-бапа-казнување-на-насилството-про/>

⁴ Tekst i publikuar në portalin: <https://iportal.mk/makedonija/spasovski-ochigledno-e-deka-nekoj-ja-zloupotrebil-svojata-polozhba-za-napad-vrz-novinarite-i-pratenicite/>

2.3. Partitë për të "Enjten e përgjakshme" dhe sulmi ndaj gazetarëve

Të enjten e përgjakshme me sulmin ndaj deputetëve, të punësuarve në Kuvend, gazetarëve dhe kameramanëve, janë sulmuar demokracia, rendi kushtetues por edhe mendimi dhe shprehja e lirë. Kështu thonë nga Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (LSDM). Sipas tyre, pa dallim nëse bëhej fjalë për gazetarë, kameramanë, deputetë apo punonjës të Parlamentit, të gjithë ishin në shënjestër të sulmuesve.

“

“Kjo ngjarje ka treguar se sa dëm mund të sjellin qytetarët dhe shteti në institucionet partizane dhe jofunksionale të krijuara nga regjimi i VMRO-DPMNE-së. Kjo ishte si pasojë e „Shtetit të robëruar”. Në vend që t’u shërbejnë qytetarëve dhe shtetit, institucionet u shërbenin ekskluzivisht interesave kriminale të udhëheqjes së VMRO-DPMNE-së të kryesuar nga Nikolla Gruevski”, thanë nga LSDM.

”

Sfida e tyre, sipas LSDM-së, është në periudhën kur të gjitha institucionet duhet të profesionalizohen dhe të përmirësojnë kushtet e punës së gazetarëve.

“

“Si parti politike përgjegjëse, kryesuese e Qeverisë, përmes institucioneve marrim masa për të përmirësuar kushtet e punës gazetarëve, veçanërisht sigurinë e tyre në punë. Ne jemi të vetëdijshëm që ka ende sfida në këtë fushë, por në bashkëpunim me institucionet dhe shoqatat e gazetarëve ne jemi duke punuar në mënyrë aktive për të ngritur sigurinë e gazetarëve, kameramanëve dhe fotoreporterëve”.

”

Nga VMRO-DPMNE, e cila akuzohet për mbështetje të protestave "Për një Maqedoni të përbashkët", e cila pjesërisht provokoi një ndërhyrje në Kuvend, thonë se çdo lloj dhune është për t'u dënuar. Sipas tyre, gazetarët duhet të dëmshpërblehen në përputhje me ligjet e Republikës së Maqedonisë për dëmin e pësuar në çfarëdo forme.



“Gazetarët kanë qenë dhe mbeten zëri i publikut. Liria e fjalës dhe media kritike janë thelbësore për çdo demokraci. Gazetarët duhet të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe të jenë plotësisht të mbrojtur në punën e tyre”, thonë nga VMRO-DPMNE-ja.



Për më tepër, nga VMRO-DPMNE thonë se për të mos përsëriten skenat e pakëndshme, nevojitet ndërgjegjësim më i lartë tek faktorët politik. Ata shtojnë se programi i tyre do të sigurojë zgjidhje për të përmirësuar kushtet e punës së mediave dhe gazetarëve.



“Ne qëndrojmë në dispozicion të juve dhe të secilit të interesuar për të na dhënë sugjerime për problemet dhe nevojat me të cilat përballeni në punë, pasi vetëdija e qeverisë siç mund ta shihni për momentin është shumë e ulët. Ne jemi këtu dhe jemi të gatshëm përmes iniciativave të përbashkëta për të punuar për një atmosferë pune më të mirë profesionale për gazetarët dhe punonjësit e mediave”, deklaruan nga VMRO-DPMNE.



Nga Aleanca për Shqiptarët, të cilët gjithashtu ishin prekur nga ngjarjet e 27 prillit, sepse lideri i tyre Ziadin Sela ishte një nga më të lënduarit, thonë se gjatë këtyre dy viteve të fundit shumë pak është biseduar për gazetarët që morën pjesë në Kuvend për ta kryer punën e tyre.



„Personat përgjegjës duhet të përgjigjen për atë që bënë, dhe më së shumti për dëmet që u janë bërë atyre që ishin atje për të bërë punën e tyre. Në këtë rast ne po flasim për gazetarët për të cilët flitet shumë pak gjatë dy viteve të fundit. Kjo është arsyeja pse Aleanca për Shqiptarët kërkoi dhe vazhdon të kërkojë përgjegjësi, si dhe dëmshpërblim për të gjithë ata që pësuan dhunë. Ata që ngritën dorën kundër Kuvendit dhe gazetarëve, ngritën dorën kundër demokracisë dhe sipas ligjeve të vendit tonë nuk duhet të mbeten të pandëshkuar”, deklaruan nga Aleanca për Shqiptarët.



2.4. Gazetarët sakrifikuan jetën e tyre për t'i transmetuar skenat e përgjakshme

Marina Tuneva, Drejtore Ekzekutive e Këshillit për Etikë në Mediat në Maqedoni (KEMM), tha se shumë kolegë gazetarë, kameramanë dhe fotografë mundësuan që publiku të shihte atë që po ndodhte atë ditë, në atë "kafaz", ndërsa tmerri ishte akoma në eter dhe me një çmim të jetës së tyre. Sipas saj, ishte një ditë që u hodh, kushedi së në cilën herë sistemi i vetë-shkarkimit, dita e një civilizimi që preku fundin, thelluar, konfirmimi i ekzistencës së një kaosi të paparë, errësirës dhe dekadencës.

“

“Sulmet që ndodhën atë ditë, ishin në fakt një sulm ndaj të drejtës së publikut për të ditur për atë që po ndodhte, mbi vlerat demokratike, mbi konceptin e së vërtetës. Incidente të tilla dërgojnë një mesazh ‘justifikimi’ për dhunën dhe sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve të mediave edhe në rrethana të tjera”, tha Marina Tuneva nga KEMM.

”

Ajo shoti se Qeveria duhet publikisht, pa mëdyshje dhe në mënyre sistematike të dënojë çdo dhunë, frikësim, kërcënim dhe sulm ndaj gazetarëve dhe punonjësve të mediave.

“

“Mosndëshkimi është një pengesë serioze, kurse hetimi dhe përndjekja penale e krimeve kundër gazetarëve dhe punonjësve të mediave në të gjitha rrethanat duhet të ndiqet me urgjencë. Qeveria është në një pozicion “unikat” për të ndihmuar për t'i dhënë fund dhunës dhe dëmeve ndaj mediave”, tha Tuneva.

”

Tuneva shton se është thelbësore, para së gjithash, të ndryshohet diskursi aktual politik i cili shpesh i portretizon mediat si "armiq". Udhëheqësit politikë, krijuesit e mendimeve publike duhet t'i mbrojnë mediat dhe punonjësit e mediave si një aset të demokracisë, jo për ta bërë punën e tyre të vështirë.

3. REZOLUTA E GJYKATËS PËR GAZETARËT E SULMUAR MË 27 PRILL

Në aspektin penalo-juridik, gazetarët kanë statusin e "personave që kryejnë punë me interes publik". Janë të përfshirë në Kodin Penal në nenin 122, paragrafi 9, i cili thotë:

“

“Kur një person i cili kryen funksione të interesit publik nënkupton një person i cili kryen funksione, detyra ose vepra me interes publik, përkatësisht interes publik, siç është mësuesi, arsimtari, mjeku, punonjësit social, gazetari, noteri publik, avokat ose person tjetër që punët ata punë i kryen në mënyrë të pavarur ose në një person juridik i cili kryen një veprimtari me interes publik ose të përgjithshëm të përcaktuar me ligj”.

”

Por, ky përshkrim nuk u jep privilegje gazetarëve e as nuk siguron mbrojtje më të madhe se çdo qytetar tjetër në vend. Sulmet fizike ndaj përfaqësuesve të mediave gjatë ndërhyrjes parlamentare, së bashku me numrin e deputetëve të dëmtuar, janë regjistruar si një goditje e rëndë për demokracinë. Si argumentet për kryerjen e një vepre penale edhe prokuroria edhe gjykata, për ndodhitë që dolën nga trazirat në Kuvend, në vendimet e tyre edhe gazetarët i kanë theksuar si të lënduar dhe sulmuar. Frekuentimi i përdorimit të termit "gazetar i sulmuar" nuk korrespondon me përndjekje dhe aktvendimet e shqiptuara penale.

3.1. Përgjegjësia penale

Raportet e para kriminale nga Ministria e Punëve të Brendshme në Prokurori u parashtruan tre ditë pas trazirave në Kuvend. Më 30 Prill 2017, Njësia e Krimit të Dhunshëm SPB Shkup denoncoi 15 persona për përndjekje penale. Sipas veprimeve të përshkuara në raport, ata kanë përdorur forcë fizike dhe kërcënime, kanë kryer dhunë ndaj njerëzve dhe kanë dëmtuar pronë.

Pas procedimit të akuzave në Prokurorinë e Shkupit dhe ngritjes së aktakuzës, aktgjykimi i parë për këtë ngjarje u shqiptua me **23 maj 2017**, për veprën penale "Pjesëmarrja në një turmë për të parandaluar një zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare".. Për nëntë të akuzuarit gjykata shqiptoi dënim me kusht.

Me 14 korrik 2017, Ministria e Punëve të Brendshme deri tek Prokurorisë Prokurorinë e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit i paraqiti të gjitha informacionet që lidhen me lidhen me 27 Prillin. Ky raport rezultoi me procedura më serioze penale.

Statistikat e Gjykatës Penale në Shkup tregojnë se një "luftë" e ashpër për demokracinë në bankinën e Prokurorisë vendosi 74 persona. Të dënuarit e shkallës së parë kishin një rol të ndryshëm dhe, me këtë, masa e dënimit ishte ndryshe. Për veprën penale "Dhuna" në shkallën e parë u dënuan gjithsej 10 persona, kurse 21 persona janë shpallur fajtorë për pjesëmarrje në turmë që nuk i lejonte zyrtarët të punonin.

Për tentimin për vrasjen e deputetit nga Aleanca për Shqiptarët, Zijadin Sela, tashmë ka një aktgjykim të formës së prerë të konfirmuar nga Gjykata e Apelit e Shkupit. Në numër, gjithsej 81 vjet burg për dhjetë të pandehurit. Çështja nuk është kompletuar, sepse para se të konfirmojë Gjykata e Apelit, i pandehuri Nikolla Vojminovski ka ikur nga arresti shtëpiak.

I dëmtuari i vetëm në këtë çështje është deputeti Sela, i cili kërkoi 500,000 euro dëmshpërblim nga të pandehurit gjatë gjyqimit. Deputeti kërkoi shumë e këtij kompensimi për shkak të trajtimeve të shtrenjta mjekësore jashtë vendit, ku u trajtua për plagët e rënda që pësoi në Kuvend. Gazetarët dëshmuar gjithashtu gjatë gjyqimit si dëshmitarë të dhunës. Rasti më i rëndë përfshinte 34 të akuzuarit për terrorizëm, kërcënim ndaj rendit kushtetues dhe sigurisë që morën gjithsej 211 vjet burg. Por, në këtë procedurë nuk ka asnjë të dëmtuar, pikërisht për shkak të cilësimit të veprës penale e cila përbën një akt kundër shtetit.

Numri i lëndës	Vepër penale	Numri i të akuzuarve
K-1013/18	Dhunë	1 person
K-1077/18	Dhunë	1 person
K-1132/18	Pjesëmarrja në turmë që do të parandalojë një zyrtar të kryejë një aktivitet zyrtar	4 persona
K-1163/18	Dhunë	2 persona
K-1330/17	Dhunë	1 person
K-1558/18	Dhunë	1 person
K-1560/18	Pjesëmarrja në turmë që do të parandalojë një zyrtar të kryejë një aktivitet zyrtar	7 persona
K-1893/17	Vrasje	10 persona
K-1991/18	Dhunë	1 person
K-602/18	Pjesëmarrja në turmë që do të bëjë vepër penale	1 person
K-701/18	Dhunë	1 person
K-752/17	Pjesëmarrja në turmë që do të parandalojë një zyrtar të kryejë një aktivitet zyrtar	9 persona
K-874/18	Dhunë	2 persona
K-990/17	Pjesëmarrja në turmë që do të parandalojë një zyrtar të kryejë një aktivitet zyrtar	1 person
KOK-40/18 KOK-56/18 595-87/18 Në rrjedhën e mëtejshme tre lëndët bashkohen në 40/18	Kërcënim terrorist ndaj rendit kushtetues	34 persona

Burimi: Gjykata Themelore Penale Shkup

3.2. Parahetimi kryesor për mbrojtjen penale të gazetarëve dy vite e gjysmë „në ler“

30 maj viti 2017. Një muaj pas të enjtes së përgjakshme në Prokurorinë Publike të Shkupit ftohet gazetarja e parë Dushica Mrgja - punonjëse e TV 24-it, një dëshmitare okulare e dhunës. Në dëshminë e saj para prokurores Zorica Pavloviq, Mrgja dëshmoi se ajo ishte sulmuar fizikisht nga një person deri me tani me identitet të panjohur. Si dëshmi për dhunën ndaj saj paralajmëron edhe dokumentacionin mjekësor. Ndër të tjera, gazetarja shpjegon dhe jep rrëfime për aktet që janë kryer si vepra dhune ndaj të tjerëve të pranishëm në sallën

e Kuvendit. Gjashtë ditë më vonë, dy gazetarë të tjerë dhe një kameraman nga "Telma", Sonja Nikolovska, Bobi Hristov dhe Jane Markovski u thirrën në Prokurori për t'u marrë në pyetje. Për dallim nga dëshmitari i parë, ata nuk raportojnë për dhunë fizike gjatë raportimit të ditës kritike. Dëshmia e tyre është përqendruar në përshkrimin e veprimeve të sulmuesve ndaj deputetëve. Në periudhën vijuese, prokurorja për këtë analizë konfirmon se ajo thirri njëzet punonjës të tjerë të mediave që ishin të pranishëm më 27 prill në Kuvend. Por, vetëm një rast është identifikuar për sulm ndaj një ekipi gazetarësh.



“U thirrën më shumë gazetarë dhe kameramanë në shqyrtimin kryesor për të cilat nga incizimet mund të përcaktonim se kush i goditi. Ata që nuk mund të identifikohen është e vështirë të ndiqen penalisht. Deri më tani nuk është dorëzuar dokumentacion mjekësor nga asnjë nga dëshmitarët, edhe pse ishte paralajmëruar”, thotë prokurorja Pavllloviq.



Shefi aktual i Prokurorisë së Shkupit, Sasho Rajçev, për këtë hulumtim sqaron se çështjen e ka ndjekur në këtë fazë, dhe sipas të gjitha fakteve pengesa kryesore qëndron në faktin se asnjë person nuk është identifikuar si sulmues ndaj gazetarëve. Paralajmërimet për çdo ndryshim nuk mund të parashikohen nga deklaratat e tyre.



“Unë u emërova në pozitën e ushtruesit të detyrës Shef i Prokurorisë Publike Shkup në dhjetor të vitit 2017. Kam bërë një inspektim të të gjitha lëndëve që kanë të bëjnë me 27 Prillin dhe faktet specifike të kësaj prokurorie janë që policia nuk ka ngritur kallëzime penale kundër individëve të veçantë që sulmuan gazetarët. Së dyti, nuk ka asnjë tregues për personin që sulmoi gazetaren. Nga të gjitha deklaratat që i ka prokuroria, nuk është identifikuar asnjë person me identitet. Ne jemi duke trajtuar 11 raste për vepra të ndryshme që rrjedhin nga lënda PP-lënda e ngjarjeve të 27 prillit. Bazuar në këto kontrolle në koordinim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, asnjë person nuk është identifikuar”, thotë Rajçev.



Këtë rast Prokuroria Publike Shkup e ka hapur pasi ka marrë një raport nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe nuk është mbyllur akoma, pra ka ngelur

në vend. As gazetarët dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë nuk u informuan për rrjedhën e kësaj procedure.



“Ne nuk kemi asnjë informacion zyrtar për rastin në pjesën e gazetarëve të dëmtuar. Ne, si përfaqësues të disa prej tyre, nuk kemi marrë ende asnjë informacion nga Prokuroria në lidhje me procedurën. Duke pasur parasysh faktin se tani ekziston rreziku i vjetërsimit në procedurat civile, ne po mbledhim dokumentacion me ata gazetarë që do të vendosin të padisin Republikën e Maqedonisë”, thotë avokati Filip Medarski.



3.3. Rasti me kameramanin e sulmuar qëndron në vend nëpër labirintet e gjykatës për dy vjet

Nga marrja në pyetje e gazetarëve, kameramanëve dhe fotografëve për të cilët Prokuroria pretendon se i ka thirrur për të dëshmuar, vetëm një sulmues është ndjekur penalisht. Më 27 prill, Nikolla Ordevski ishte duke punuar si kameraman në Kuvend. Kur turma e zemëruar hynë në pres-sallën ai tashmë ishte i pranishëm dhe po dokumentonte dhunën, deri në momentin kur merr një goditje e fortë në kokë dhe natën e përfundon në klinikat e Shkupit me tronditje në tru. Ordevski ndan më shumë detaje në prokurori, por edhe në sallën e gjyqit.

Më 16 maj të vitit 2018, Prokuroria e Shkupit ngriti aktakuzën e parë dhe të vetmen kundër një personi, Ilija Petrushevski dhe një kameramani të dëmtuar, Nikolla Ordevski. Gjyqi kundër Petrushevskit po mbahet për krimin e "Dhunës". Në këtë rast, kryeministri Zoran Zaev dhe ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës Damjan Mançevski paraqiten si dëshmitarë.

Pas më shumë se një viti, çështja është në procedurë të provave (dhjetor 2019) dhe nuk ka përfundim gjyqësor. Një nga arsyet e vonesës është Ligji për amnisti, i cili u miratua njëzëri nga Kuvendi në dhjetor të vitit 2018 me 95 vota pro. Ilija Petrushevski është ndër ata që kërkuan mëshirë nga gjykata. Ligji nuk parashikonte emra dhe mbiemra se cili do të shpëtojë nga ndjekja penale, por ishte thujtë se sigurt se cili nuk do të shpëtojë. Midis tyre ishte Ilija Petrushevski, i cili u refuzua për amnisti. Shumica u falën në rastin më të keq.

Nga 33 të paditur të akuzuar për rrezikimin e rendit kushtetues dhe sigurinë, numri i të paditurve u përgjysmua në 18.

Mendim pozitiv lidhur me kërkesën për amnisti morën pesë deputetët - Kërsto Mukoski, Luben Arnaudov, Saso Vasilevski, Johan Tarçulovski dhe Lupco Dimovski, organizatorët e nismës "Për një Maqedoni të përbashkët" - Bogdan Ilievski, Vllado Jovanovski dhe Boris Damovski, të punësuarit në Kabinetin e kryetarit të atëhershëm të Kuvendit Ivan Cvetanovski dhe Elena Docevska-Bozhinovska, vëllezërit Stefan dhe Mihail Mlladenovski të cilët të parët zbuluan detaje për organizimin e të enjtes së përgjakur dhe Zaharije Simovski, Ilija Sllavevski dhe Mitre Pitropovski, përfaqësues të shoqatave patriotike.

- Neni 1

(1) Me këtë ligj lirohen nga veprat penale, ndërpriten procedurat për përndjekje penale dhe janë plotësisht të liruar nga vuajtja e dënimit me burg (në tekstin e mëtejshëm "amnisti") personat që dyshohet se kanë kryer një krim në lidhje me ngjarjet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë nga 27 Prilli 2017...

*4) Ky përjashtim nuk vlen për autorët e krimit **"Dhuna" të përmendur në nenin 386 të Kodit Penal**, si dhe autorët e krimit "Shoqata për veprimtari armiqësore" të përmendur në nenin 324 të Kodit Penal në lidhje me nenet 18, 19, 23 dhe 24 i Kodit Penal. (fragment nga Ligji për Amnistinë për personat e dyshuar, të akuzuar dhe të dënuar për ngjarjet e Kuvendit më 27 prill të vitit 2017)*

Edhe pse nuk ka amnisti, procedurat e paraqitjes së kërkesës e shtyjnë procesin gjyqësor për një periudhë të shkurtër. Prokurorja Pavloviç sqaron se ky është i vetmi rast në të cilin ka një përfaqësues të dëmtuar të mediave, sepse sulmuesi është gjetur.



"Ordevski Nikolla është ftuar edhe në procesverbalin edhe në seancën gjyqësore kryesore sepse për të dihet kush dhe si e ka lënduar. Ne i pamë incizimet dhe dhamë udhëzime dhe policia e identifikoi më tej atë. Ky sulmues nuk është i mbuluar dhe lehtë mund të identifikohet", tha prokurorja Pavloviç.



3.4. Rruga për drejtësi është më e shkurtër në procedurat

Duke pritur drejtësinë në Gjykatën Penale, kameramani i Agjencisë së lajmeve Makfax, Nikolla Ordevski dhe kolegja e tij, gazetarja Gabriela Dimovic Misevska, ndërkohë parashtrojnë padi për kompensimin e dëmit si të lënduar dhe dëmtuar gjatë kryerjes së detyrave të tyre në Kuvend. Kërkesa e dëmshpërblimit e Mishevskës është në shumë prej 350,000 denarë për shkak të stresit të përjetuar, kurse Ordevski kërkon 450,000 euro dëmshpërblim sepse u sulmua fizikisht.

“

“Aktpadija deri tek Gjykata Themelore Civile është parashtruar më 11 dhjetor të vitit 2019 për dy përfaqësues të mediave. Është përgatitur ekspertizë mjekësore, përfshirë një raport neuropsikiatrik. I kemi parashtruar në bazë të Ligjit për marrëdhëniet obligative se në rast të akteve të dhunës ose terrorit në demonstrata ose manifestime publike përgjigjet shteti. Sipas të njëjtit ligj për dhimbjet fizike dhe shpirtërore, shkelje e të drejtave të personalitetit u takon kompensim për dëmet dhe mbi këtë bazë ne presim që shteti t’i paguajë. Paditësit ishin të pranishëm në Kuvend pavarësisht konfuzionit, ankthit dhe frikës”, tha avokati Zvonko Davidoviq.

”

3.5. Legjislacioni i sigurisë së gazetarëve

Procedurat e gjata gjyqësore janë arsyeja pse gazetarët po humbin gjithnjë e më shumë besimin në drejtësi, në rastet kur ata janë viktimë. Çështje që duhet ta zgjidhë dhe ngritë sigurinë e tyre është akoma e hapur. Angazhimet kryesore pas skenarit të përgjakshëm në Kuvend më 27 prill të shoqatave të gazetarëve, ShGM dhe SSNM janë në orientuar në ndryshimet e legjislacionit në fushën e mbrojtjes. Kërkohe zgjidhje që do të garantojnë ditë më të sigurta në fushëveprimin e raportimit gazetaresk. Një nga mendimet është gjithashtu përmes ndërhyrjes në Kodin Penal (KP) në pjesën e mbrojtjes në nivelin e personave zyrtar. Por, jo edhe të barazohen në aspekt terminologjik, sepse në atë mënyrë në paketë me të drejtat, do të imponohen të njëjtat detyra dhe përgjegjësi që i kanë personat zyrtarë.



“Është e domosdoshme të rritet mbrojtja penale-ligjore e gazetarëve në mënyrë që ata të gëzojnë të njëjtën mbrojtje si zyrtarët tjerë gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Për ta arritur këtë, duhet të ndërhyhet në pjesën speciale të Kodit Penal dhe në të gjitha ato pjesët ku ekziston rreziku i mundshëm potencial i rrezikimit të gazetarëve, të parashikohet një formë e kualifikuar, më e rreptë nëse i dëmtuari është gazetar që ushtron profesionin”, thotë avokati Filip Medarski.



Me ndërmjetësim të OSBE-së, grupi i punës i Ministrisë së Drejtësisë tashmë është duke punuar në hartimin e një ligji ndëshkues, ndërsa zhvillohet diskutim edhe për forcimin e të drejtave të gazetarëve në materien penale, potencojnë nga Ministria.



“Kjo çështje është e hapur në grupin e punës që punon në hartimin e Kodit të ri Penal. Po rishikohet së bashku me çështjet e mëparshme që përfshijnë mënyrën e përcaktimit të statusit të gazetarit në proceset gjyqësore, veçanërisht në media elektronike”, thonë nga Ministria e Drejtësisë.



Një aspekt i çështjes së sigurisë është se gazetarët nuk i përkasin natyrshëm grupit të zyrtarëve, por që pozicioni i tyre në jetën shoqërore në korrelacion me Kodin Penal është “person që kryen punë me interes publik”, siç janë mjekët, avokatët, mësuesit... Një nga variantet e padëshirueshme është se nëse gazetarëve u jepet statusi i zyrtarëve, ekziston rreziku që të vendoset ligji penal mbi ta, ashtu që do të arrihej qëllimi i kundërt.

Hyrja në grupin e personave zyrtarë, gazetarët do të duhet të përgjigjen edhe për shpërdorim të detyrës, vepër për të cilën dënimi i caktuar është mbi gjashtë muaj burg. Identifikimi i gazetarëve si zyrtarë do të rrisë mundësinë organeve të zbatimit të ligjit për të përdorur masa speciale hetimore (MSH) kundër gazetarëve.

Në fund të fundit, liria e shprehjes do të humbte kuptimin e saj, pasi që me statusin e “zyrtarit” imponohet edhe përgjegjësia penale për tekstin e shkruar, diçka që Maqedonia e largoi në vitin 2012. Një nga aspektet më të favorshme

është mbrojtja e gazetarëve si persona më të ekspozuar ndaj situatave të krizës për t'u ngritur deri në një nivel më të lartë me plotësimin e veprave penale konkrete (rrezikimi të sigurisë, dhunë, sulm ndaj një zyrtari, etj.) në të cilin viktimat ose objektet e sulmit janë gazetarët, dhe sulmi në këtë rast të barazohet me masën e dënimit sikur të ishte sulm ndaj një zyrtari.

Në këtë mënyrë gazetarët - viktimat të krimit, të cilët tashmë trajtohen si "persona me interes publik", do të barazoheshin me zyrtarët viktimat dhe të mos përgjigjen si kryerës të veprave penale.



Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

www.znm.org.mk

www.znm.org.mk